



# Shkeljet e procedurave administrative: Rastet me grantet e fermerëve

## Hyrje

Ndarja e granteve dhe subvencioneve mbetet një ndër çështjet më të ndjeshme që nga prezantimi i skemave të para mbështetëse për sektorin e bujqësisë në vitin 2009, me miratimin e Ligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.<sup>1</sup> Ky ligj, që tashmë është shfuqizuar, shënoi një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të ndihmës financiare për fermerët dhe nxitjes së zhvillimit rural. Aktualisht, sektori udhëhiqet nga Ligji i ri për Bujqësinë<sup>2</sup> dhe një kornizë e gjerë ligjore dhe rregullatore që synon përmirësimin e këtyre proceseve.

Megjithatë, ky sistem ka hasur shpesh në sfida të vazhdueshme dhe skandale të theksuara. Rasti i njohur në publik si “Subvencionet 2021”, ku u arrestuan 78 zyrtarë të lartë të Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për keqpërdorime fondesh, shënoi një pikë kulmore të dyshimeve për abuzime dhe mungesë të transparencës në menaxhimin e fondeve publike.<sup>3</sup> Për më tepër, raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) kanë theksuar vazhdimisht sfidat në administrimin e granteve dhe subvencioneve, duke identifikuar praktika të paefektshme dhe mungesë të respektimit të procedurave.<sup>4</sup>

Në kontrast me këto raste të ekspozuara publikisht, ky raport i shkurtër trajton dy raste administrative të monitoruara në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ku fermerët kanë kontestuar vendime administrative të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (tutje: Ministria e Bujqësisë) dhe të Agjencisë

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i shfuqizuar më 30.03.2023. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71733>

2 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 08/L-072 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71733>

3 Paparaci.com. “Aksioni “Subvencionet” vuri në pranga 78 persona”, 3 dhjetor, 2021. I qasshëm në: <https://paparaci.com/32143/aksioni-subvencionet-vuri-ne-pranga-78-persona/>

4 Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti i auditimit të performancës: “Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e Bujqësisë”, maj 2019. I qasshëm në: [https://ëëë.zka-rks.org/cms/uploads/2019/05/2019\\_05\\_07\\_Procesi\\_i\\_menaxhimit\\_te\\_granteve\\_dhe\\_subvencioneve\\_ne\\_bujqesi.pdf](https://ëëë.zka-rks.org/cms/uploads/2019/05/2019_05_07_Procesi_i_menaxhimit_te_granteve_dhe_subvencioneve_ne_bujqesi.pdf)

për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB). Këto raste, ndonëse nuk përfshijnë akuza për keqpërdorim fondesh apo korrupsion, nxjerrin në pah probleme të tjera të rëndësishme, si mosrespektimi i procedurave ligjore dhe mungesa e transparencës. Për pasojë, fermerëve u është shkaktuar dëm i konsiderueshëm nga këto autoritete publike, duke i detyruar të kërkojnë drejtësi në gjykatë. Këto raste pasqyrojnë sfidat e vazhdueshme të fermerëve gjatë aplikimeve për mbështetje financiare dhe theksojnë pretendimet për padrejtësi dhe mungesë transparence në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike.

Qëllimi i këtij raporti është që të nxjerrë në pah rëndësinë e respektimit të procedurave ligjore duke inkurajuar qytetarët të ndjekin rrugët ligjore në rast se të drejtat e tyre nuk respektohen nga organet publike. Raporti përmban një prezantim të shkurtër të kornizës ligjore që rregullon ndarjen e granteve dhe subvencioneve dhe të procedurës administrative që duhet ndjekur nga palët e prekura deri në paraqitjen e rasteve në gjykatë, si dhe ilustrimin e dy rasteve të monitoruara në gjykatë. Në fund, raporti ofron përfundime dhe rekomandime që synojnë përmirësimin e proceseve administrative dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve.

## Korniza ligjore dhe procedura administrative

Sektori i bujqësisë mbështetet nga Qeveria e Kosovës përmes fondeve direkte në formën e subvencioneve dhe granteve, bazuar në Ligjin për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.<sup>5</sup> Këto fonde administrohen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ministria harton programe zhvillimore afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata për të mbështetur projektet bujqësore.

Një institucion kyç në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë është Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, e cila është përgjegjëse për zbatimin e masave për bujqësi dhe zhvillim rural. Gjithashtu, Ministria e Bujqësisë miraton çdo vit Udhëzime Administrative për pagesat direkte, duke përcaktuar rregullat, kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat për mbështetjen financiare të fermerëve aplikues.

Në të dy rastet e monitoruara, paditësit kishin ndjekur të gjitha procedurat ligjore përpara se rastet të paraqiteshin në gjykatë. Pas njoftimit me vendimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe AZHB-së, ata paraqitën ankesa tek Komisioni i Ankesave të kësaj ministrie dhe në mungesë të zbatimit të vendimeve të këtij komisioni nga ana e ministrisë, ata më pastaj i'u drejtuan Departmentit Administrativ pranë Gjykatës Themlore në Prishtinë, siç parashihet me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Ky ligj parashikon mundësinë e ngritjes së një konflikti administrativ kundër:

- aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë.
- aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar.<sup>6</sup>

<sup>5</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 08/L-072 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71733>

<sup>6</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative. Neni 13. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85181>

Po ashtu, konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.<sup>7</sup>

**Rasti i parë:** Komisioni i Ankesave miratoi kërkesën e paditësit dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim tek organi i shkallës së parë, Ministria e Bujqësisë. Megjithatë, ky organ refuzoi të zbatonte vendimin e Komisionit, duke neglizhuar sugjerimet e tij. Andaj, paditësi vendosi të sfidonte vendimin e Ministrisë së Bujqësisë në gjykatë.

**Rasti i dytë:** Pas refuzimeve të përsëritura nga organet administrative, Ministria e Bujqësisë -AZHB dhe Komisioni i Ankesave, ky paditës po ashtu iu drejtua gjykatës përmes procedurës administrative, siç parashikohet me Ligjin për Konfliktet Administrative (LKA).

Sipas LKA, “në procedurën e konfliktit administrativ mund të kërkohet edhe kthimi i sendeve të marra dhe kompensimi i dëmit që i është shkaktuar paditësit më ekzekutimin e aktit që kontestohet”.<sup>8</sup>

Në të dyja rastet, palët paditëse kishin kërkuar gjithashtu realizimin e kamatëvonesës prej 8%, sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton: “Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”,<sup>9</sup> si dhe: “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.”<sup>10</sup>

## Rasti 1

### Padia e L.S.A. kundër AZHB pranë Ministrisë së Bujqësisë për refuzimin e mbështetjes financiare pas inspektimit të dytë në terren

Në këtë çështje të konfliktit administrativ, Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur në favor të fermerit L.S.A., duke anuluar vendimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë për refuzimin e mbështetjes financiare bazuar në kontratën e lidhur fillimisht ndërmjet palëve.

Fermeri kishte aplikuar për mbështetje financiare për përkrahje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural në vitin 2020, për masën 101, nën masën 101.2.1: Investimet e Perimeve dhe Serrave për projektin “Ngritja e serrës 0.21ha dhe ujitja”, dhe pas kontrollës administrative, vlerësimit dhe kontrollës së parë në terren, projekti u miratua nga AZHB pranë Ministrisë së Bujqësisë. Sipas kontratës, Ministria do të financonte 65% të vlerës së projektit, që kapte shumën prej 29,646 euro. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, fermerit iu dha një paradhënie prej 9,634.95 euro për ndërtimin e një serre sipas planit të biznesit.

Megjithatë, pas inspektimit të dytë në terren nga AZHB, inspektorët përkatës konstatuan se skeleti metalik i serrës ishte i përdorur, çka çoi në refuzimin e pagesës së mëtejshme. Ky vendim për refuzim u konfirmua më pas nga Komisioni i Ankesave të Ministrisë në shtator 2021, i cili e dërgoi çështjen për rishqyrtim dhe rivendosje te AZHB. Megjithatë, AZHB nuk e mori parasysh këtë vendim të Komisionit dhe sërish refuzoi kërkesën e fermerit.

<sup>7</sup> Po aty, Neni 14.

<sup>8</sup> Po aty, Neni 17.

<sup>9</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 170. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828>

<sup>10</sup> Po aty, Neni 382.

Andaj, fermeri, i pakënaqur, paraqiti padi në Gjykatën Themelore, duke argumentuar se AZHB kishte shkelur dispozitat ligjore dhe kishte vlerësuar gabimisht gjendjen faktike gjatë inspektimit të dytë. Ai paraqiti një ekspertizë private, e cila konfirmonte se materiali i përdorur për serrën ishte i ri. Kjo ekspertizë u pranua pa kundërshtime nga Komisioni i Ankesave të Ministrisë së Bujqësisë. Gjithashtu, ministria nuk ofroi prova të tjera, si fotografi nga terreni, për të sfiduar gjetjet e ekspertizës.

Gjykata, pas shqyrtimit të provave, arriti në përfundimin se Ministria e Bujqësisë, kishte kryer gabime procedurale dhe nuk kishte siguruar prova të mjaftueshme për vendimin e saj. Raporti i ekspertit të ndërtimtarisë, i paraqitur nga fermeri, vërtetoi se skeleti metalik ishte i ri dhe ndryshimi i ngjyrës ishte pasojë e kushteve atmosferike. Eksperti deklaroi se materiali nuk ishte i vjetër, por kishte ndryshuar ngjyrë nga ndikimi i elementeve natyrore. Vlerësimi në terren konfirmoi se struktura ishte ndërtuar një vit më parë dhe kishte qëndrueshmëri për 20 deri në 40 vjet, në varësi të trashësisë së zinkimit.

Këtë ekspertizë, gjykata e cilësoi më të besueshme dhe profesionale në krahasim me raportin e inspektorëve të ministrisë. Ajo vuri në dukje se inspektorët e AZHB-së nuk kishin kryer matje profesionale të trashësisë së zinkimit dhe nuk kishin dokumentuar gjendjen e serrës me fotografi apo të kërkonin informacione shtesë nga fermeri. Këto mangësi u cilësuan si joprofesionale dhe të njëanshme, duke mos përmbushur standardet e një inspektimi objektiv.

Nga ana tjetër, e paditura, ndonëse pranoi ekspertizën e gjykatës, nuk e kundërshtoi me prova apo propozoi një ekspertizë tjetër për të sfiduar gjetjet.

Në vendimin e saj, gjykata iu referua Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural<sup>11</sup> dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Bujqësisë për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për vitet 2020-2021.<sup>12</sup> Sipas këtij udhëzimi, shpenzimet për makineri dhe pajisje të përdorura janë të papranueshme, por gjykata konstatoi se ministria nuk kishte vërtetuar se materiali i përdorur ishte i tillë.<sup>13</sup>

Gjykata shqyrtoi edhe provat e tjera materiale dhe, me vendim përfundimtar, anuloi vendimin e Ministrisë si të paligjshëm, duke e detyruar atë të paguajë shumën prej 9,634.95 euro, së bashku me kamatë ligjore prej 8%, që nga data e parashtrimit të padisë më 26 tetor 2021.<sup>14</sup>

11 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=71733>

12 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) nr.02/2020 për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural për Vitin 2020-2021. I qasshëm në: [https://ëëë.mbpzhr-ks.net/repository/docs/PDF\\_Nr\\_02\\_2020-UA\\_20072020.pdf](https://ëëë.mbpzhr-ks.net/repository/docs/PDF_Nr_02_2020-UA_20072020.pdf)

13 Po aty, Neni 33.

14 Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr. 2536/2021. Datë: 15.05.2024.

## Rasti 2

### Padia e E.V. kundër AZHB pranë Ministrisë së Bujqësisë për refuzimin e mbështetjes financiare për shkak të një gabimi teknik në dokumentacion

Në këtë rast, procedura gjyqësore dhe administrative për fermerin E.V. mbetet ende e hapur, duke përfshirë një periudhë të zgjatur prej rreth 7 vitesh, gjatë së cilës rasti ka kaluar përmes vendimeve të disa niveleve gjyqësore. Fillimisht, Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi në favor të fermerit, duke anuluar vendimet e Ministrisë së Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë lidhur me refuzimin e mbështetjes financiare për projektin e tij bujqësor. Ky vendim konfirmoi se gabimi teknik në dokumentacion nuk përbënte bazë të ligjshme për refuzimin e aplikimit të tij

Fermeri kishte aplikuar për mbështetje financiare për projekte bujqësore në vitin 2017 dhe ishte renditur i pari në listën e përfituesve të granteve. Megjithatë, aplikacioni i tij u refuzua për një gabim teknik në dokumentacion. E.V. lidhur me këtë bëri ankesë te Komisioni i Ankesave të Ministrisë së Bujqësisë, i cili aprovoi ankesën duke kthyer çështjen për rishqyrtim dhe rivendosje, por që kjo nuk u mor parasysh nga organi i parë dhe u refuzua sërish.

Vetëm pas kësaj, E.V. paraqiti padi në gjykatë, duke pretenduar se refuzimi i aplikacionit të tij nuk kishte asnjë bazë ligjore, ngase paditësi është renditur i pari në listën e përfituesve të granteve, përveç një gabimi teknik në aplikacion ku në vend të mbiemrit V. është shkruar A., dhe kjo sipas të paditurës nuk mund të konsiderohet arsye për refuzim të ankesës pasi që paditësi asnjëherë nuk është njoftuar nga e paditura për gabim teknik, në mënyrë që i njëjti të mund të bëjë korrigjimin e tij, i cili gabim është vetëm në faqen e parë të aplikacionit.

Në anën tjetër, e paditura e ka kundërshtuar në tërësi kërkesë-padinë e paditësit, duke arsyetuar se refuzimi i aplikacionit të paditësit ndodhi në fazën e shqyrtimit administrativ, që është faza e parë dhe kusht për kalimin në fazat e tjera. Sipas të paditurës, kërkesëpadija për kompensim dhe fitim të humbur është juridikisht e papranueshme, pasi nuk janë krijuar marrëdhënie kontraktuale siç parashikohet me ligj dhe bazën nënligjore për kontrollet e detyrueshme në vendngjarje.

Gjykata, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më 15 mars 2023, gjatë administrimit të provave konstatoi se vendimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe AZHB ishin të paligjshme. Gjykata theksoi se gabimi teknik nuk përbënte bazë të mjaftueshme për refuzim dhe se autoritetet kishin dështuar të përmbushnin standardet ligjore për aktet administrative, të përcaktuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), konkretisht nenet 47 dhe 48, të cilat përcaktojnë elementet e detyrueshme që duhet të përmbajë një akt administrativ.<sup>15</sup>

Lidhur me pretendimin e Ministrisë së Bujqësisë se nuk ishin krijuar marrëdhënie kontraktuale fillimisht, gjykata, duke u bazuar në shkresat e lëndës, vërtetoi se kjo kishte ndodhur si rezultat i vlerësimit të gabuar të gjendjes faktike nga ana e të paditurës. Për më tepër, gjykata konstatoi se Komisioni i Ankesave pranë kësaj ministrie fillimisht kishte aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e kishte dërguar çështjen për rishqyrtim. Megjithatë, ankesa ishte refuzuar herën e dytë pa dhënë asnjë arsyetim të mjaftueshëm.

<sup>15</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenet 47 dhe 48. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

Vendimi i Gjykatës Themelore e obligonte Ministrinë e Bujqësisë që të kompensonte fermerin me shumën prej 98,200 euro, që përfshinte dëmin material, fitimin e humbur dhe kamatën ligjore prej 8% për periudhën katërvjeçare nga data e parashtrimit të padisë më 28 dhjetor 2017 deri në pagesën përfundimtare.<sup>16</sup> Megjithatë, rasti nuk përfundoi këtu.

Fermeri E.V., i pakënaqur me këtë vendim, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke kërkuar ndryshimin e vendimit për të përfshirë një shtesë kompensimi prej 71,575 euro (në total 134,300 euro), bazuar në ekspertizën financiare të caktuar nga pala dhe të aprovuar nga gjykata, që përfaqësonte vlerësimin financiar të humbjeve shtesë të tij. Gjykata e Apelit e konsideroi ankesën të bazuar, duke konstatuar se Gjykata Themelore nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme për të mos miratuar kërkesën e plotë të paditësit. Kjo gjykatë gjeti se Gjykata Themelore kishte kryer shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Kontestimore (LPK), konkretisht nenet 183 dhe 184, duke mos i arsyetuar qartë vendimet e saj. Për këtë arsye, çështja u kthye për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.<sup>17</sup>

Aktualisht, rasti mbetet në proces në Gjykatën Themelore, e cila duhet të veprojë sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit dhe të shqyrtojë në tërësi kërkesën e paditësit.

<sup>16</sup> Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr. 2214/17. Datë: 15.05.2024.

<sup>17</sup> Vendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë në Prishtinë, AA.nr.442/2023. Datë: 13.06.2024.

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në të dy rastet e monitoruara, vendimet e Ministrisë së Bujqësisë dhe AZHB-së janë anuluar nga gjykatat për shkak mos respektimit të procedurave administrative në përputhje me ligjet. Kjo ka vërtetuar se një administratë shtetërore që nuk respekton procedurat ligjore mund të shkaktojë dëm të konsiderueshëm për qytetarët dhe bizneset, në këtë rast fermerët, si dhe për vetë shtetin, për shkak të kompensimit të tyre me kamatë ligjore prej 8% të përcaktuar me Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve.<sup>18</sup> Autoritetet publike kanë shkelur dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, veçanërisht nenet 47 dhe 48, të cilat përcaktojnë detyrimin për përfshirjen e elementeve të caktuara në një akt administrativ.

- **Rasti i parë:** Për shkak të një gabimi të inspektorëve të ministrisë në terren, të cilët vlerësuan gabimisht gjendjen faktike dhe nuk ofruan asnjë dëshmi për këtë vlerësim, vendimi i organit administrativ u anulua nga Gjykata Themelore.
- **Rasti i dytë:** Për shkak të një gabimi teknik në dokumentacion, palës paditëse iu refuzua mbështetja financiare për projekte në bujqësi. Autoritetet publike nuk e kishin informuar palën për mundësinë e korigjimit të këtij gabimi, siç parashikohet në udhëzimet administrative. Ky veprim çoi në një proces gjyqësor që ka zgjatur rreth shtatë vite dhe ende nuk ka arritur një përfundim. Kjo për shkak të vendimeve të Gjykatës Themelore, të cilat nuk ishin arsyetuar mjaftueshëm, duke e çuar çështjen dy herë në Gjykatën e Apelit, e cila e ktheu dy herë në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim.

Bazuar në monitorimin e këtyre rasteve, rekomandohet:

1. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë pranë Ministrisë së Bujqësisë, të respektojë dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht nenet 47 dhe 48, për të siguruar korrektësinë dhe ligjshmërinë e akteve administrative.
2. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë pranë Ministrisë së Bujqësisë duhet të zbatojë në mënyrë rigorozë udhëzimet administrative që i harton, duke njoftuar palët për mundësinë e korigjimit të gabimeve teknike, siç parashikohet me aktet nënligjore siç janë Udhëzimet Administrative për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes për Zhvillim Rural.
3. Gjykata Themelore, Departamenti për Çështje Administrative, duhet të shmangë zvarritjet, ashtu siç ka ndodhur me rastin e dytë, dhe të sigurojë që rastet të mos kthehen përsëri nga instancat më të larta. Për këtë, ajo duhet të arsyetojë vendimet në mënyrë të qartë, duke respektuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, konkretisht nenet 183 dhe 184.

<sup>18</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 382. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828>